

**Vendim nr. 269, datë 22.10.2025**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

|                   |           |
|-------------------|-----------|
| Fiona Papajorgji, | Kryesuese |
| Ilir Toska,       | Anëtar    |
| Marjana Semini,   | Anëtare   |

në datën 22.10.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 11 (T) 2025 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** TOM DEDAJ

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimit nr. 1, datë 13.03.2025 të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Shfuqizimi i pikës 2 të dispozitivit të vendimit nr. 1, datë 13.03.2025 të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, që bën fjalë për vendosjen e gjobës prej 100, 000 lekësh kundrejt kërkuarit.

Konstatimi i zhvillimit të një procesi të parregullt ligjor kundrejt kërkuarit.

Konstatimi i diskriminimit.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 11 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 31/c, 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

## **V Ë R E N:**

### **I**

#### **Rrethanat e çështjes**

1. Kërkuesi ka ushtruar detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër. Në datën 24.10.2016 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, nisur nga një program televiziv i transmetuar në datën 21.10.2016, në një televizion kombëtar, ka regjistruar procedimin penal në ngarkim të kërkuesit për veprën penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, të parashikuar nga neni 319/ç të Kodit Penal (*KP*). Me urdhrin nr. 271, datë 31.10.2016, Prokurori i Përgjithshëm ka vendosur pezullimin e kërkuesit nga ushtrimi i detyrës, deri në përfundim të hetimeve të procedimit penal.

2. Me vendimin nr. 88, datë 26.07.2018, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka vendosur deklarinin fajtor të kërkuesit për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, të parashikuar nga neni 319/ç të *KP*-së, dhe dënimin e tij me 3 vjet burgim. Në zbatim të neneve 30, pika 1, 35 dhe 44, paragrafi 2 të *KP*-së, gjykata ka dhënë si dënim plotësues heqjen e së drejtës së kërkuesit për të ushtruar funksione publike për 5 vjet, ndërsa në zbatim të nenit 59 të *KP*-së ka vendosur pezullimin e dënimit me burgim dhe vënien e të dënuarit në provë për një periudhë 5-vjeçare, me kushtin që gjatë kohës së provës të mos kryejë vepër tjetër penale.

3. Për ankimin e kërkuesit, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, me vendimin nr. 89, datë 06.11.2018, ka ndryshuar cilësimin ligjor, duke vendosur deklarinin fajtor të kërkuesit për kryerjen e veprës penale “Moskallëzimi i krimit”, të parashikuar nga neni 300 i *KP*-së dhe dënimin e tij me 1 vit burgim, në zbatim të nenit 59 të *KP*-së, pezullimin e dënimit me burgim dhe vënien e kërkuesit në provë për një periudhë 2-vjeçare, si dhe dënim plotësues për heqjen e së drejtës për kërkuesin për të ushtruar funksione publike për 1 vit.

4. Bazuar në vendimin e formës së prerë nr. 89, datë 06.11.2018 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, Këshilli i Lartë i Prokurorisë (*KLP*), me vendimin nr. 22, datë 28.01.2019

(vendimi nr. 22/2019), ka vendosur shkarkimin nga detyra të kërkuessit. Kundër këtij vendimi kërkuessi ka ushtruar ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit (KPA), duke kërkuar shfuqizimin e vendimit nr. 22/2019 të KLP-së, kthimin në vendin e mëparshëm të punës dhe dhënien e pagës nga data 28.01.2019 e në vazhdim.

5. Me vendimin nr. 1, datë 20.07.2020, KPA-ja ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes nr. 1, datë 19.12.2019 të juridiksionit disiplinor. Ky kolegji ka vlerësuar se kërkuessi edhe pse ka pasur dijeni për shqyrtimin e çështjes nuk është paraqitur, si dhe nuk ka paraqitur kërkesë për shtyrjen e seancës për ndonjë shkak të arsyeshëm.

6. Në datën 26.02.2021 kërkuessi i është drejtuar KPA-së me kërkesë për deklarimin e paligjshëm të vendimit dhe shfuqizimin e vendimit nr. 22/2019 të KLP-së dhe kthimin në detyrën e mëparshme të prokurorit, dhënien e pagës nga data 28.01.2019 e në vazhdim. Me vendimin nr. 1, datë 06.05.2021, KPA-ja ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, pasi është paraqitur përtej afatit ligjor 4-mujor.

7. Në datën 09.07.2021 kërkuessi i është drejtuar përsëri KPA-së me kërkesë për gjykimin e çështjes së pushuar. Me vendimin nr. 2, datë 04.10.2021, KPA-ja ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, me arsyetimin se kërkesa nuk plotësonte kriteret ligjore për kalimin për shqyrtim në seancë plenare.

8. Me kërkesën e datës 10.08.2023 kërkuessi ka paraqitur sërish kërkesë, me objekt rigjykimin e çështjes së gjykuar nga ky kolegji me vendimin nr. 1, datë 20.07.2020. Me vendimin nr. 1, datë 13.03.2025, KPA-ja ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare dhe vendosjen e gjobës prej 100,000 lekësh, në ngarkim të kërkuessit. Sipas KPA-së, kërkuessi ka përdorur në mënyrë abuzive të drejtën e tij për akses në gjykatë, ka treguar mungesë respekti dhe përgjegjshmërie në mënyrën sesi i është drejtuar asaj, jo vetëm duke përsëritur disa herë të njëjtën kërkesë, për të cilën ka marrë përgjigje, por edhe duke shtrembëruar faktet e paraqitura (*shih faqen 13 të vendimit të KPA-së*).

9. Në datën 04.07.2025 kërkuessi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 24.07.2025.

## II

### Pretendimet e kërkuessit

10. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar *e drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

10.1. *Së drejtës për gjykim nga një gjykatë e paanshme dhe e caktuar me ligj*, pasi vendimi i KPA-së është i padrejtë, i pabazuar në prova, i paarsyetuar, pra antikushtetues. Kërkesa për rigjykim nuk ishte e përsëritur, pasi bazohej në faktin e dënimit me vendim gjyqësor të formës së prerë të anëtarit të KPA-së A.H. Ky i fundit ka qenë anëtar i të gjitha kolegjeve të shqyrtimit paraprak të kërkesave të paraqitura nga kërkuesi, për të cilat në KPA janë dhënë vendimet nr. 1, datë 20.07.2020, nr. 1 datë 06.05.2021 dhe nr. 2, datë 04.10.2021. KPA-ja, duke vendosur gjobë në bazë të nenit 31/c të ligjit nr. 8577/2000, ka marrë kompetencat e Gjykatës, kur në fakt është një seksion i posaçëm “sui generis” i saj. Për më tepër, që, referuar kësaj dispozite, gjoba vendoset nga Mbledhja e Gjyqtarëve dhe jo nga një kolegji i shqyrtimit paraprak.

10.2. *Parimit të mosdiskriminimit*, pasi KPA-ja ka keqinterpretuar ligjin me qëllim për të rrëzuar kërkesën për gjykimin e çështjes së kërkuesit. Të gjitha kërkesat e paraqitura janë shqyrtuar nga e njëjta anëtare e KPA-së, I.R.

### III

#### Vlerësimi i Kolegjit

##### *A. Për juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese*

11. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, kur është palë në një proces ligjor ose kur është bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, mund të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese. Objekt i gjyimit kushtetues mund të jetë çdo akt i pushtetit publik ose vendim gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë e parashikuara në Kushtetutë.

12. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, llojin e pasojave negative të pësuar, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Megjithatë, përmbajtja e nenit 131,

pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës ka bërë një përjashtim nga rregulli i mësipërm, për rastet kur parashikohet ndryshe në Kushtetutë.

13. Dispozitat kalimtare të Kushtetutës, konkretisht neni 179/b, pika 5, parashikojnë se gjatë periudhës kalimtare 9-vjeçare Gjykata Kushtetuese do të funksionojë me dy kolegje, një prej të cilave është KPA-ja. Në mbështetje të këtij parashikimi, edhe neni 179, pika 7, fjalia e dytë, parashikon se gjatë mandatit të saj 9-vjeçar KPA-ja shqyrton edhe ankimet ndaj vendimeve të këshillave për vendosjen e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve.

14. Në rastin konkret, rezulton se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual për kundërshtimin e vendimin nr. 1, datë 13.03.2025 të KPA-së, me të cilin ndaj tij është vendosur gjobë dhe moskalimi për shqyrtim në seancë plenare i kërkesës së përsëritur për rigjykimin e çështjes së gjykuar, me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 22/2022 të KLP-së për shkarkimin nga detyra, kthimin në vendin e mëparshëm në detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, dhënien e pagës nga data 30.11.2018 e deri në rifillimin e detyrës.

15. Bazuar në nenin 179/b, pika 7, të Kushtetutës, juridiksioni i Gjykatës në shqyrtimin e ankimit kushtetues individual për çështje që lidhen me procesin disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve është i kufizuar nga vetë Kushtetuta, e cila në Aneksin e saj këto kompetenca ia ka deleguar KPA-së, si organ kushtetues dhe dhomë e Gjykatës gjatë periudhës së funksionimit sipas mandatit të saj 9-vjeçar. Vetëm në përfundim të këtij mandati kjo kompetencë do të ushtrohet nga Gjykata. Rrjedhimisht, kompetenca e KPA-së për proceset e juridiksionit disiplinor dhe të gjitha elementet e gjykatës së caktuar me ligj që KPA-ja duhet të përmbushë në këto lloj procesesh janë të përcaktuara nga vetë normat kushtetuese dhe baza ligjore përkatëse. Kushtetuta ka ngarkuar KPA-në të jetë organi i cili duhet të ofrojë të gjitha garancitë që kërkon e drejta për një proces të rregullt ligjor, përfshirë të drejtën e ankimit, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së. Në këtë kuptim, pretendimet që lidhen me procedurat e shkarkimit të këtyre subjekteve, siç është rasti konkret, nuk mund të jenë objekt shqyrtimi në Gjykatë (*shih vendimin nr. 17, datë 09.02.2021 të Mbledhjes së Gjyqtarëve*).

16. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk legjitimohet t’i drejtohet Gjykatës, nëpërmjet ankimit kushtetues individual për pretendime që i përkasin procesit të ankimit të masës disiplinore të dhënë ndaj tij, vendim që ka natyrë përfundimtare brenda sistemit të brendshëm të ankimeve.

17. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk i plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

**PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

**V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.